# DËSHMI ARKIVI

**A-431576**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Katari: Hapja e Ngushticës së Hormuzit, prioriteti kryesor për të shmangur përshkallëzimin – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/katari-hapja-e-ngushtices-se-hormuzit-prioriteti-kryesor-per-te-shmangur-pershkallezimin/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 22:52:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 20:24:27 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6b456a482cf489517cb0d56778002ae794c3b3e31f4eaa0a74859aeacda85ed9` |
| TEKSTI | `686fd82497d503d79ef6f82ef2555be9b407b533697b8a5628370029985ca61d` |
| PAMJA | `a268d6f3597eff451c325d0e4fb707853644feb103945bb7a933bcde86f1515e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `48f6cdff335546cbd67b0d4cfa79c42bf1c15ef93c6eedfc0f040f8eaa96e942` |
| E MËPARSHMJA | `61d04fc0bd4a693a75bd7e819f34924980fe3c0d99f6317651d7f9abd6e85230` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/48f6cdff335546cbd67b0d4cfa79c42bf1c15ef93c6eedfc0f040f8eaa96e942`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

vendi që po ndërmjetëson mes SHBA-së dhe Iranit i ka thënë CNN se prioriteti kryesor është hapja e Ngushticës së Hormuzit.

"*Kemi dy prioritete kryesore: E para është të sigurojmë që ngushtica të jetë e hapur dhe që presioni ekonomik mbi të gjithë ne kolektivisht… të hiqet. E dyta është të sigurojmë që të mos ketë përshkallëzime ushtarake në rajon*," deklaroi Al-Ansari.

Ai theksoi se nuk duhet të "ngrihet pezull" ky konflikt, për t'u rikthyer sërish pas disa muajsh.

"*Bota nuk mund të përballojë normalizimin e idesë që një ngushticë, një rrugë ujore, të përdoret dhe të kthehet në armë në këtë lloj konflikti. Kjo mund të përsëritet edhe në vende të tjera, me pasoja edhe më të dëmshme. Duhet ta ndalim këtë që në fillim. Nuk mund të bëhet normale e re e luftës që vendet thjesht të mbyllin rrugët ujore në këtë mënyrë"*, ka theksuar Al-Ansari.

Al-Ansari kujtoi se perandoritë janë ngritur dhe janë rrëzuar pikërisht nga kontrolli mbi rrugë të tilla ujore, duke sjellë vdekje e shkatërrim në nivele të paimagjinueshme kur siguria detare është cenuar.

"*Bota sot, vetëm me një ngushticë të prekur në këtë mënyrë, po përballet me probleme inflacioni, me probleme të sigurisë energjetike, me probleme të sigurisë ushqimore; po përballet me një katastrofë industriale nëse kjo vazhdon*", shtoi ai.

Sipas tij, ka shumë pengesa për një zgjidhje: njëra ka të bëjë me vullnetin

5 Gjirokastër/ Flakët pranë stallave të lopëve, zjarrfikësit parandalojnë…

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

politik, tjetra është thjesht teknike dhe lidhet me gjetjen e zgjidhjeve teknike.

#Katari #mgushticaehormuzit #VizionPlus

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:17



BOTA

**Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 19:36



BOTA

**Trump: Lufta me Iranin do të...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 18:51

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv · Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.